LIGJ
Nr.10 086, datë 26.2.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE "PËR BARRËT DHE HIPOTEKAT DETARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën ndërkombëtare "Për barrët dhe hipotekat detare".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6093, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA NDËRKOMBËTARE
MBI BARRËT DHE GARANCITË HIPOTEKORE DETARE
(Gjenevë, 6 maj 1993)

Shtetet palë në këtë Konventë,

të vetëdijshme mbi nevojën për të përmirësuar kushtet e financimit të anijeve dhe zhvillimit të flotave kombëtare tregtare.

duke pranuar dëshirën për uniformitet ndërkombëtar në fushën e barrëve dhe garancive hipotekore detare dhe si pasojë;

të bindur mbi domosdoshmërinë për një instrument ligjor ndërkombëtar që do të drejtojë garancitë hipotekore dhe barrët detare;

kanë vendosur të lidhin një Konventë për këtë qëllim dhe për rrjedhojë kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Njohja dha zbatimi i garancive hipotekore, "hipotekave" dhe detyrimeve

Garancitë hipotekare, "Hipotekat" dhe detyrimet e regjistrueshme të një natyre të njëjtë, të cilat detyrime të regjistrueshme të së njëjtës natyrë do të referohen më poshtë si "detyrime" të aplikueshme për mjetet lundruese detare, njihen dhe zbatohen në shtetet palë, me kusht që:

a) Garancitë hipotekare, "hipotekat" dhe detyrimet në fjalë të jenë realizuar dhe regjistruar në përputhje me ligjin e shtetit në të cilin mjeti lundrues është i regjistruar;

b) Regjistri dhe çdo instrument që kërkohet të depozitohet pranë regjistruesit në përputhje me ligjin e shtetit në të cilin mjeti lundrues është regjistruar të jenë të hapura për inspektim publik dhe se fragmente nga regjistri dhe kopje të instrumenteve në fjalë të jenë të disponueshme prej regjistruesit;

c) ose regjistri ose çdo instrument i referuar në nënparagrafin (b) të specifikojë të paktën

emrin dhe adresën e personit, në favor të të cilit është realizuar garancia hipotekore, “hipoteka” apo detyrimi ose shuma maksimale e siguruar t’i jetë lëshuar mbajtësit, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ligji i shtetit të regjistrimit apo nëse shuma në fjalë specifikohet në instrumentin që krijon garancinë hipotekore, “hipotekën” ose detyrimin dhe datën dhe të dhëna të tjera të cilat, sipas ligjit të shtetit të regjistrimit, përcaktojnë renditjen në lidhje me garancitë hipotekore, “hipotekat” dhe detyrimet e tjera të regjistruara.

Neni 2
Renditja e garancive hipotekare, “hipotekave” dhe detyrimeve

Niveli i garancive hipotekore të regjistruara, “hipotekave” apo detyrimeve siç është vendosur ndërmjet tyre dhe pa cenuar dispozitat e kësaj Konvente, efekti i tyre për sa i përket palëve të treta përcaktohet nga ligji i shtetit të regjistrimit; megjithatë, pa cenuar dispozitat e kësaj Konvente, të gjitha çështjet, lidhur me procedurën e zbatimit, rregullohen nga ligji i shtetit ku ndodh zbatimi.

Neni 3
Ndryshimi i pronësisë ose regjistrimit

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga nenet 11 dhe 12, në të gjitha rastet e tjera që shkaktojnë çregjistrimin e mjetit lundrues nga regjistri i një shteti palë, një shtet palë i tillë nuk duhet të lejojë pronarin të çregjistrojë mjetin lundrues pa fshirë më parë të gjitha garancitë hipotekore, “hipotekat” ose detyrimet, ose pa siguruar pëlqimin me shkrim të të gjithë zotëruesve të garancive hipotekore, “hipotekave” ose detyrimeve të tilla. Megjithatë, atje ku çregjistrimi i mjetit lundrues është i detyrueshëm në përputhje me ligjin e shtetit palë, në rastet kur nuk është rezultat i një shitje të vullnetshme, zotëruesit e garancive hipotekore, “hipotekave” ose detyrimeve të regjistruara njoftohen mbi çregjistrimin në fjalë me qëllim që t’u japin mundësi zotëruesve të tillë të ndërmarrin masat e duhura për të mbrojtur interesat e tyre, përveçse kur zotëruesit bien dakord, çregjistrimi nuk duhet të bëhet më herët se skadimi i një periudhe të arsyeshme kohore, e cila nuk duhet të jetë më e pakët se tre muaj mbas njoftimit përkatës të zotëruesve në fjalë.

2. Pa cenuar nenin 12, paragrafi 5, një anije, e cila është regjistruar në një shtet palë, nuk është e pranueshme për t’u regjistruar në një shtet palë tjetër, përveçse kur:

a) të jetë lëshuar një certifikatë prej shtetit të mëparshëm me efektin që anija është çregjistruar; ose

b) të jetë lëshuar një certifikatë prej shtetit të mëparshëm me efektin që mjeti lundrues do të çregjistrohet menjëherë kur regjistrimi i ri të jetë realizuar. Data e çregjistrimit duhet të jetë data e regjistrimit të ri të mjetit lundrues.

Neni 4
Barrët detare

1. Secila nga pretendimet e mëposhtme ndaj pronarit, çerteruesit demise/bareboat, menaxherit apo operatorit të mjetit lundrues sigurohen nga barrët detare mbi mjetin lundrues:

a) Pretendime për rroga dhe shuma të tjera kundrejt kapitenit, oficerëve dhe anëtarëve të tjerë të mjetit lundrues për sa i përket punësimit të tyre përfshirë kostot e riatdhesimit dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që paguhen në emër të tyre;

b) Pretendime për sa i përket humbjes së jetës ose dëmtimeve personale që ndodhin, në tokë apo në det, dhe kanë lidhje direkte me operimin e mjetit lundrues;

c) Pretendime për shpërblime për shpëtimin e mjetit lundrues;

d) Pretendime për tarifat portuale, kanalet dhe rrugët e tjera ujore dhe tarifat e pilotimit;

e) Pretendime bazuar në dëme jokontraktuale që lindin nga humbja fizike ose dëmtimi që shkaktohet nga operimi i mjetit lundrues, përveç humbjes apo dëmtimit të ngarkesës, kontenierëve dhe sendeve të pasagjerëve të cilët transportohen me mjet lundrues.

2. Asnjë barrë detare nuk i ngarkohet mjetit lundrues për të siguruar pretendime të

përcaktuara në nënparagrafët (b) dhe (e) të paragrafit 1 të cilat lindin si rezultat i:

a) Dëmtimit në lidhje me transportimin me rrugë detare të naftës apo substancave të tjera të rrezikshme ose të dëmshme për të cilat kompensimi është i pagueshëm ndaj pretenduesit në bazë të konventave ndërkombëtare ose ligjit kombëtar, të cilat parashikojnë përgjegjësi absolute dhe siguracion të detyrueshëm ose mënyra të tjera për të siguruar pretendimet; ose

b) vetive radioaktive ose një kombinimi të vetive radioaktive me veti toksike, eksplozive dhe substanca të tjera të rrezikshme të lëndëve djegëse bërthamore ose të produkteve apo mbetjeve radioaktive.

Neni 5

Prioriteti i barrëve detare

1. Barrët detare, të përcaktuara në neni 4, kanë prioritet ndaj garancive hipotekore, "hipotekave" dhe detyrimeve të regjistruara dhe asnjë pretendim tjetër nuk ka prioritet kundrejt barrëve detare të tilla ose garancive hipotekore, "hipotekave" dhe detyrimeve, të cilat pajtohen me kërkesat e nenit 1, përveçse kur parashikohet në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 12.

2. Barrët detare, të përcaktuara në neni 4, renditen sipas rendit që listohen (në atë nen), duke siguruar sidoqoftë që barrët detare, të cilat sigurojnë pretendime për shpërblime për shpëtimin e mjetit lundrues, do të kenë prioritet ndaj të gjitha barrëve detare, të cilat i janë ngarkuar mjetit lundrues para kohës së realizimit të operacioneve që çuan në lindjen e barrëve në fjalë.

3. Barrët detare, të përcaktuara në secilin prej nënparagrafëve a, b, d, dhe e të paragrafit 1 të nenit 4, klasifikohen *pari passu* ashtu siç klasifikohen ndërmjet tyre.

4. Barrat detare që sigurojnë pretendime për shpëtimin e mjetit lundrues, renditen në bazë të rendit të kundërt të kohës kur ndodhën pretendimet e siguruara në këtë mënyrë. Pretendime të tilla çmohen të kenë ndodhur në datën në të cilën secilit operacion shpëtimi iu dha fund.

Neni 6

Barrë të tjera detare

Secili shtet palë mund, sipas ligjit të tij, të akordojë barrë të tjera detare mbi mjetin lundrues për të siguruar pretendime, të ndryshme nga ato të referuara në nenin 4 kundrejt pronarit, çarteruesit demise/bareboat, menaxherit apo operatorit të mjetit lundrues, me kusht që barrë të tilla:

a) T'u nënshtrohen dispozitave të neneve 8, 10 dhe 12;

b) Të shuhen

i) pas një periudhe 6-mujore nga koha kur u lindën pretendimet e siguruara në këtë mënyrë, përveçse kur para skadimit të një periudhe të tillë mjeti lundrues të jetë arrestuar ose sekuestruar, gjë e cila çon në shitje të detyrueshme; ose

ii) në fund të një periudhe 60-ditore mbas shitjes së mjetit lundrues një blerësi *bona fide* (në mirëbesim), periudha në fjalë të fillojë në datën në të cilën shitja të jetë regjistruar në përputhje me ligjin e shtetit në të cilën anija është regjistruar mbas shitjes:

cilado qoftë periudha që përfundon më parë; dhe

c) do të renditen pas barrëve detare, të përcaktuara në nenin 4, dhe gjithashtu pas garancive hipotekore, "hipotekave" ose detyrimeve të regjistruara, të cilat pajtohen me dispozitat e nenit 1.

Neni 7

Të drejtat e mbajtjes/prezervimit

1. Secili shtet palë mund të akordojë sipas ligjit të tij të drejtën e ruajtjes për sa i përket një mjeti lundrues në zotërimin ose të:

a) Një ndërtuesi mjetesh lundruese për të siguruar pretendimin për ndërtimin e saj; ose

b) Një riparuesi mjetesh lundruese për të siguruar pretendimin për riparim, përfshirë rikonstruksionin e mjetit lundrues të realizuar gjatë një zotërimi të tillë.

2. Këto të drejta mbajtjeje/prezervimi shuhen kur mjeti lundrues pushon së qeni në zotërim të ndërtuesit ose riparuesit të saj, përveçse kur ndodh si pasojë e një arrestimi ose sekuestrimi.

Neni 8

Karakteristikat e barrëve detare

Në varësi të dispozitave të nenit 12, barrët detare ndjekin mjetin lundrues, pavarësisht nga ndryshimet e pronësisë, regjistrimit apo flamurit.

Neni 9

Zhdukja e barrëve detare me kalimin e kohës

1. Barrët detare, të përcaktuara në nenin 4, shuhen mbas një periudhe 1-vjeçare, përveçse kur para mbarimit të një periudhe të tillë, mjeti lundrues është arrestuar ose sekuestruar, gjë e cila çon në një shitje të detyrueshme.

2. Periudha njëvjeçare, referuar në paragrafin 1, fillon:

a) përsa i përket barrës detar, të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1 (a), me pushimin/largimin e pretenduesit nga mjeti lundrues;

b) përsa u përket sigurimeve detare, të përcaktuara në nenin 4, nga paragrafi 1 (b) deri në (e), kur dalin/ realizohen pretendimet e siguruara në këtë mënyrë,

dhe nuk i nënshtrohen pezullimit apo ndërprerjes, duke siguruar megjithatë që koha nuk do të llogaritet gjatë periudhës kur arrestimi i mjetit lundrues nuk lejohet me ligj.

Neni 10

Transferimi dhe zëvendësimi i së drejtës

Transferimi i një pretendimi apo zëvendësimi me një pretendim të siguruar nga një barrë detare nënkupton transferimin ose zëvendësimin e njëkohshëm të barrës detare në fjalë.

Kërkuesit që zotërojnë barrë detare mund të mos zëvendësohen për një kompensim të pagueshëm pronarit të mjetit lundrues në bazë të një kontrate sigurimi.

Neni 11

Njoftimi i shitjes së detyruar

1. Para shitjes së detyruar të një mjeti lundrues në një shtet palë, autoriteti kompetent në një shtet të tillë siguron që të njoftohen në përputhje me këtë nen:

a) Autoriteti përgjegjës për regjistrin në shtetin e regjistrimit;

b) Të gjithë zotëruesit e garancive hipotekore, “hipotekave”, apo detyrimeve të regjistruara, të cilat nuk i janë lëshuar mbajtësit;

c) Të gjithë zotëruesit e garancive hipotekore “hipotekave” ose detyrimeve të lëshuara mbajtësve dhe të gjithë zotëruesit e barrëve detare, të përcaktuara në nenin 4, me kusht që autoriteti kompetent që kryen shitjen e detyruar të marrë njoftim mbi pretendimet e tyre përkatëse; dhe

d) Pronari i regjistruar i anijes.

2. Një njoftim i tillë sigurohet të paktën 30 ditë para shitjes së detyruar dhe duhet të përmbajë ose:

a) Kohën dhe vendin e shitjes së detyruar dhe të dhëna të tilla lidhur me shitjen e detyruar ose procedurat që çuan në një shitje të tillë, ndërsa autoriteti në shtetin palë që drejton procedurat, përcakton nëse është e mjaftueshme mbrojtja e interesave të personave të cilët gëzojnë të drejtën e njoftimit; ose

b) Nëse koha dhe vendi i shitjes së detyruar nuk mund të përcaktohet me siguri, koha e përafërt dhe vendi i parashikuar i një shitjeje të tillë dhe të dhëna të tilla në lidhje me shitjen e detyruar, ndërsa autoriteti në shtetin palë që drejton procedurat përcakton nëse është e mjaftueshme mbrojtja e interesave të personave të cilët gëzojnë të drejtën e njoftimit.

Nëse njoftimi sigurohet në përputhje me nënparagrafin (b), njoftimi shtesë i vendit dhe kohës

aktuale të shitjes së detyruar jepen kur ato dihen por, në çdo rast jo më pak se shtatë ditë para shitjes së detyruar.

3. Njoftimi i specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni u niset personave të interesuar, nëse njihen, sipas specifikimeve të nenit 1, me shkrim ose niset me postë rekomande ose në mënyrë elektronike apo në mënyra të tjera të përshtatshme, të cilat sigurojnë konfirmimin e marrjes. Për më tepër, njoftimi jepet me anë të njoftimit në shtyp në shtetin ku është realizuar shitja e detyruar dhe, nëse gjykohet e përshtatshme nga ana e autoritetit që drejton një shitje të tillë, në publikime të tjera.

Neni 12
Efektet e shitjes së detyruar

1. Në rastin e shitjes së detyruar në një shtet palë, të gjitha garancitë hipotekore, "hipotekat" ose detyrimet e regjistruara, me përjashtim të atyre të marra përsipër nga ana e blerësit me pëlqimin e zotëruesve, dhe të gjitha barrët detare dhe barrë të tjera të çfarëdo lloj natyre, pushojnë së detyruari mjetin lundrues, me kusht që:

a) Në kohën e shitjes, mjeti lundrues të jetë në zonën e juridiksionit të këtij shteti; dhe

b) Shitja të jetë realizuar në përputhje me ligjin e shtetit në fjalë dhe dispozitat e nenit 11 dhe këtij neni.

2. Kostot dhe shpenzimet që lindin për pasojë të arrestit apo sekuestrimit dhe shitjes në vijim të mjetit lundrues paguhen të parat nga të ardhurat e shitjes. Kosto dhe shpenzime të tilla përfshijnë, ndër të tjera, kostot për mirëmbajtjen e mjetit lundrues dhe ekuipazhit si dhe rrogat, shuma dhe kosto të tjera të referuara në nenin 4, paragrafi 1"a", të shkaktuara që nga koha e arrestit apo sekuestrimit. Bilanci i të ardhurave shpërndahet në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente në shtrirjen e nevojshme për të plotësuar pretendimet përkatëse. Pas plotësimit të të gjitha pretendimeve, pjesa e mbetur e të ardhurave, nëse ka, i paguhet pronarit dhe është lirisht e transferueshme.

3. Një shtet mund të parashikojë në ligjin e tij se, në rastin e shitjes së detyruar të një mjeti lundrues të fundosur apo të ngecur në cektinë pas zhvendosjes së tij nga ana e një autoriteti publik për interes të lundrimit të sigurt apo mbrojtjes së mjedisit detar, shpenzimet e një zhvendosjeje të tillë të paguhen nga të ardhurat e shitjes para të gjitha pretendimeve të tjera të siguruara nga barrë detare mbi mjetin lundrues.

4. Nëse në kohën e shitjes së detyrueshme, mjeti lundrues është në zotërim nga një ndërtues mjetesh lundruese apo riparues mjetesh lundruese, të cilët sipas ligjit në shtetin palë ku ndodh shitja, gëzojnë të drejtën e mbajtjes, ndërtuesi dhe riparuesi në fjalë duhet t'i dorëzojnë zotërimin e mjetit lundrues blerësit, por gëzojnë të drejtën e plotësimit të pretendimit të tyre nga të ardhurat e shitjes, pasi të jenë plotësuar pretendimet e zotëruesve të barrëve detare, të përmendura në nenin 4.

5. Kur një mjet lundrues i regjistruar në një shtet palë ka qenë objekt i një shitjeje të detyruar në secilin shtet palë, autoriteti kompetent me kërkesë të blerësit, lëshon një certifikatë për të shpjeguar se mjeti lundrues është shitur pa asnjë garanci hipotekore, "hipotekave" apo detyrimeve të regjistruara, përveç atyre të pretenduara nga ana e blerësit dhe të gjitha barrëve detare dhe barrëve të tjera, me kusht që të pajtohen kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 (a) dhe (b). Me lëshimin e një certifikate të tillë, regjistruesi është i detyruar të fshijë të gjitha garancitë hipotekare, "hipotekat" apo detyrimet e regjistruara, përveç atyre të pretenduara nga ana e blerësit dhe të regjistrojë mjetin lundrues në emrin e blerësit ose të lëshojë një certifikatë çregjistrimi për qëllim të një regjistrimi, sipas rastit.

6. Shtetet palë sigurojnë se çdo e ardhur nga shitja e detyruar të vihet në dispozicion dhe të transferohet lirshëm.

Neni 13
Fusha e zbatimit

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, dispozitat e saj zbatohen për të gjitha mjetet lundruese të regjistruara në një shtet palë ose në një shtet, i cili nuk është shtet palë me kushtet

që mjetet e lundrimit të këtij të fundit t'i nënshtrohen juridiksionit të shtetit palë.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk krijon apo mundëson krijimin e ndonjë të drejte për t'u zbatuar ndaj ndonjë anije në zotërim apo operim nga ana e një shteti dhe përdorur vetëm për shërbime qeveritare jokomerciale.

Neni 14
Komunikimi ndërmjet shteteve palë

Për qëllim të neneve 3, 11 dhe 12 autoritetet kompetente të shteteve palë autorizohen të shkëmbejnë korrespondencë drejtpërdrejt ndërmjet tyre.

Neni 15
Konflikti i konventave

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk ndikon mbi aplikimin e ndonjë konvente ndërkombëtare që parashikon kufizim të përgjegjësisë apo aplikim të legjislacionit kombëtar që zbaton këto konventa.

Neni 16
Ndryshimi i përkohshëm i flamurit

Nëse një mjet lundrues i regjistruar në një shtet lejohet të mbajë përkohësisht flamurin e një shteti tjetër, procedohet si më poshtë:

a) Për qëllim të këtij neni, referimet në këtë Konventë ndaj "shtetit në të cilin mjeti lundrues është i regjistruar" ose "shtetit të regjistrimit" çmohet si referime kundrejt shtetit në të cilin mjeti lundrues ishte i regjistruar menjëherë para ndryshimit të flamurit dhe referimi kundrejt "autoritetit përgjegjës për regjistrimin" çmohet të jetë referim kundrejt autoritetit përgjegjës për regjistrimin në atë shtet.

b) Ligji i shtetit të regjistrimit mbetet përcaktues për qëllim të njohjes së garancive hipotekore "hipotekave" apo detyrimeve të regjistruara.

c) Shteti i regjistrimit kërkon një referencë të hollësishme hyrje në regjistrin e tij, ku të specifikohet shteti, flamurin e të cilit mjeti lundrues është lejuar të mbajë përkohësisht; në të njëjtën mënyrë shteti, flamurin e të cilit mjeti lundrues është lejuar të mbajë përkohësisht, kërkon që autoriteti përgjegjës për regjistrimin e mjetit lundrues të specifikojë me anë të një reference të hollësishme në regjistrin e shtetit të regjistrimit.

d) Asnjë shtet palë nuk duhet të lejojë një mjet lundrues të regjistruar në shtetin në fjalë të përdorë përkohësisht flamurin e një shteti tjetër përveçse kur të gjitha garancitë hipotekore, "hipotekat" apo detyrimet e regjistruara mbi mjetin lundrues në fjalë të jenë plotësuar më parë ose kur është dhënë pëlqimi me shkrim i zotëruesve të të gjitha garancive hipotekore, "hipotekave", apo detyrimeve.

e) Njoftimi i referuar në nenin 11, i jepet gjithashtu autoritetit kompetent përgjegjës për regjistrimin e mjetit lundrues në shtetin, flamurin e të cilit mjeti lundrues lejohet të përdorë përkohësisht.

f) Me lëshimin e certifikatës së çregjistrimit të referuar në nenin 12, paragrafi 5, autoriteti kompetent, përgjegjës për regjistrimin e mjetit lundrues në shtetin, flamuri i të cilit është lejuar të përdoret përkohësisht, me kërkesë të blerësit, lëshon një certifikatë për të shpjeguar se e drejta për të mbajtur flamurin e shtetit në fjalë është shfuqizuar.

g) Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të kuptohet si ngarkim i ndonjë detyrimi mbi shtetet palë për të lejuar mjetet e huaja lundruese të mbajnë përkohësisht flamurin e tyre ose për të lejuar mjetet kombëtare lundruese të mbajnë përkohësisht një flamur të huaj.

Neni 17
Depozitari

Kjo Konventë i depozitohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 18
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe hyrja

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga çdo shtet në selinë e Kombeve të Bashkuara. Nju Jork, nga 1 shtatori 1993 deri më 31 gusht 1994 dhe pas kësaj mbetet e hapur për hyrje.

2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u detyruar nga kjo Konventë me anë të:

a) Nënshkrimit pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin; ose

b) nënshkrimit që do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

c) aderimit.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi realizohen me anë të depozitimit pranë depozituesit të një instrumenti për këtë qëllim.

Neni 19
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi 6 muaj nga data në të cilën 10 shtete të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur prej saj.

2. Pëlqimi i një shteti për t'u lidhur nga kjo Konventë pasi të ketë plotësuar kushtet e hyrjes në fuqi të saj, bëhet i efektshëm 3 muaj nga data e shprehjes së tij.

Neni 20
Rishikimi dhe amendimi

1. Konferenca e shteteve palë me qëllim rishikimin ose amendimin e kësaj Konvente thirret nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara me kërkesë të një të tretës së shteteve palë.

2. Çdo pëlqim për t'u lidhur nga kjo Konventë, i shprehur mbas datës së hyrjes në fuqi të një ndryshimi të kësaj Konvente, gjykohet të zbatohet për Konventën e ndryshuar.

Neni 21
Denoncimi

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga një shtet palë në çdo kohë pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Konventë për atë shtet.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi me depozitimin e një instrumenti të denoncimit te depozitari.

3. Denoncimi hyn në fuqi pas një viti ose pas një periudhe më të gjatë, siç mund të specifikohet në instrumentin e denoncimit, pasi instrumenti përkatës të jetë marrë nga ana e depozitarit.

Neni 22
Gjuhët

Kjo Konventë është hartuar në një origjinal të vetëm, në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëlloj autentik.

Hartuar në Gjenevë këtë ditë të gjashtë të majit, njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre

përkatëse për këtë qëllim e kanë nënshkruar këtë Konventë.